

V E N D I M
Nr.168, datë 3.9.2003

PËR DHËNIE LICENCE

PËR RADIO VENDORE PRIVATE "SHQIP" SUBJEKTIT: "ANTENA" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "Antena" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela